



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-12282
Kaçanik, 25.06.2025

PROCESVERBAL i KONSULTIMIT PUBLIK-Me sektorin e arsimit për draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Vendi: Gjimnazi "Skenderbeu"
16.06.2025 ora 10:00

Të pranishëm në debat nga ekzekutivi komunal:

Kryetari i Komunës Besim Ilazi

Nënkryetari Sabedin Vishi

Drejtori për Buxhet dhe Financa Bahri Selimi

Drejtori për Arsim Zahir Doda

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe drejtorisë së Arsimit, ka mbajtur sot konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 me sektorin e arsimit.

Takimin e hapi Kryetari i Komunës Besim Ilazi, i cili tha se me qëllim të rritjes së transparencës po e organizojmë këtë takim publik, duke cekur se në vazhdimësi komuna ka bërë investime në arsim, si në infrastrukturë, pajisje me kabinete e mjete të tjera të punës si dhe investime në terrene sportive e në veçanti me sallat e edukatës fizike dhe hapjen e puseve për ujë të pijes në të gjitha shkollat e komunës sonë. Kryetari ceku sfidat me të cilat po ballafaqohen si institucione tash e sa vite nga mos përkrahja e nivelit qendror, ku të gjitha kërkesat tash e sa vite protokollohen dhe përcillen në ministritë e linjës, por që asnjëherë as përgjigje nuk është marrë. Nënkryetari i Komunës Sabedin Vishi shpalosi detaje nga ky dokument buxhetor, duke shtuar se buxheti për vitin e ardhshëm do të jetë afër 13 milion e 169 mijë euro, ndërsa për investime kapitale do të ndahen 2 milion e 829 mijë euro, ku në arsim parashihet të bëhen investime në infrastrukturë, në salla të edukatës fizike, vendosje e paneleve diellore në shkolla, digjitalizim të shkollave dhe kabinete si dhe në pajisje të shkollave me materiale të nevojshme.

Në takim prezantoi edhe drejtori për Arsim Zahir Doda dhe drejtori për financa Bahri Selimi, të cilët dhanë detaje nga pjesa financiare, duke shtuar se fondi për arsim bazuar për numër të nxënësve është i pamjaftueshëm dhe shpesh herë komuna ka kaluar këto kufizime duke i tejkaluar me të vetmin qëllim krijimin e kushteve sa më të mira në arsim, ku ndër vite shuma e ndarë në arsim vetëm për investime kapitale për

një vit ka kaluar gjysmë milioni. E investimet nuk janë ndalur edhe në financimin e shërbimeve të shkollave, ndarja e bursave për studentë etj.

Ndërsa nga të pranishmit u shtruan kërkesat si vijon:

Bislim Krasniqi- Drejtor në Shkollën Fillore " Qamil Ilazi" Kaçanik i Vjetër

Kërkesat në arsim janë të mëdha, po bëhet propagandë, kërkojmë të përfundohet projekti në Shkollën Fillore në Doganaj, projekt i nisur nga ministria tash e sa vite.

Atdhe Neziraj- Drejtori i ShMP " Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Sfida të mëdha në arsim , organizatat e huaja më lehtë i përkrahin projektet me sistemet solare, kërkoj që mjetet e ndara për këtë kategori të orientohen në tjera kategori.

Shefki Guri- Drejtor i Gjimnazit Skenderbeu në Kaçanik- Në shkollën tonë mungojnë edhe katër tabela digjitale për ta kompletuar këtë projekt të digjitalizimit. Po presim që këto tabela ti marrim donacion nga organizata të huaja.
Objekti i Gjimnazit " Skenderbeu" në Kaçanik ka nevojë për rinovim të sallës së edukatës fizike dhe të toaleteve.

Nazmi Gashi- Drejtor i Shkollës Fillore " 7 Shtatori" në Begracë- Rregullimi i ngrohjes qendrore një pjesë nuk funksionon, të bëhet rregullimi i saj kur të jenë mundësitë.

Agim Mjaku- Profesor – Nga vlerësimet e brendshme të shkollave, është vlerësuar që profesorët kanë nevojë për trajnime.

Valbona Raka- Pedagoge- Ju falënderoj për bashkëpunimin e treguar, kërkoj që të organizohen trajnime për stafin mësimdhënës në fusha të ndryshme.

Për të gjitha kërkesat u dhanë përgjigjet nga ana e ekzekutivit komunal, ndërsa për secilën kërkesë janë dhënë edhe përgjigjet me shkrim në raportin e dëgjimeve publike për KABK.

Procesmbajtëse:

Fatlume Guri Selimi

